



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 21.2, 61, 67 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr 28, datë 4 qershor 2008),

Me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores së AAC-së Nr. 2/2010 për Shënjimin e pengesave, të datës 15 maj 2010,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 mbi procedurat për konsultim publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 02/2013 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr. 2/2010 PËR SHËNJIMIN E PENGESAVE

Neni 1

Neni 2, ndryshohet si vijon:

Përkufizimi për "Aneksin 14" zëvendësohet me si vijon:

Aneksi 14 - nënkupton Aneksin 14 Vëllimin I "Aerodromet" dhe Vëllimin II "Heliportet", të Konventës mbi Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil të dt. 7 dhjetor 1944";

Përkufizimi për "pengesë" zëvendësohet me si vijon:

Pengesë - në lidhje me një aerodrom, nënkupton të gjitha objektet e palëvizshme (qoftë të përkohshme apo të përhershme) dhe të lëvizshme, ose pjesët e tyre, të cilat janë të vendosura në një zonë të destinuar për lëvizjen në tokë të mjeteve ajrore apo që shtrihen mbi një sipërfaqe të caktuar për qëllim të mbrojtjes së mjetit ajror në fluturim, apo qëndron jashtë këtyre sipërfaqeve të përcaktuara dhe që janë vlerësuar si të rrezikshme për navigacionin ajror.

Përkufizimet e mëposhtme do të shtohen sipas rendit fillestar alfabetik:

Aerodrom i aprovuar - nënkupton një aerodrom, operatorit të të cilit i është dhënë aprovimi i aerodromit;

Studim aeronautik - nënkupton një analizë të sigurisë së rrezikut që paraqitet gjatë operimit të një mjeti ajror në fluturim;

Pengesë gjatë rrugës (*en-route*) - nënkupton një objekt jashtë hapësirës ajrore, të përcaktuar me sipërfaqet e kufizuara të pengesave të aerodromit apo sipërfaqet e mbrojtjes nga pengesat, që arrijnë një lartësi prej 100 metra ose më shumë mbi nivelin e tokës në vendin e objektit, që ka ndikim në mjetin ajror gjatë operimeve *en-route*;

Heliport - nënkupton një aerodrom apo një zonë të caktuar në ndonjë strukturë që ka për qëllim të shfrytëzohet plotësisht apo pjesërisht për arritje, nisje dhe lëvizje të helikopterëve .”

Neni 2

Neni 4, zëvendësohet me si vijon:

4.1 Të gjitha objektet, të palëvizshme apo të lëvizshme, që gjenden brenda një rrezeje prej 15 km prej një aerodromi dhe të cilat konsiderohen të jenë pengesa për mjetet ajrore në fluturim ose për manovrim në tokë, duhet të jenë të ndriçuara gjatë natës dhe, kur pengesa nuk është mjaftueshëm e dallueshme gjatë ditës, duhet shenjuar me ngjyra të kundërta (kontraste).

4.2 Një objekt i palëvizshëm që nuk konsiderohet të jetë pengesë, që gjendet në afërsi të sipërfaqës për ngritje, duhet të shënjohe dhe, nëse pista përdoret gjatë natës, të ndriçohet, në qoftë se shënjimi dhe ndriçimi i tillë konsiderohet i nevojshëm për të siguruar shmangien e tij.

4.3 Pengesat sipërfaqësore dhe hapësirat me terren të keq në zonat e lëvizjes në aerodrom duhet të shënjohe nëpërmjet përdorimit të shenjave me ngjyra apo flamujve.

4.4 Metodat e shënjimit dhe ndriçimit të pengesave në aerodrom janë ilustruar në Pjesën 2 të Shtojcës së Rregullores.

Neni 3

Neni 6, zëvendësohet me si vijon:

Telat, kabllot dhe objektet e ngjashme, etj, të cilët kalojnë një lum, luginë, rrugë apo autorrugë duhet të shënjohe si dhe shtyllat e tyre mbajtëse duhet të shënjohe dhe ndriçohen në qoftë se një studim aeronautik tregon që telat apo kabllot mund të paraqesin rrezik për mjetet ajrore, përjashtimisht, shënjimi i shtyllave mbajtëse mund të shmanget kur ato pengesa ndriçohen me drita të intensitetit të lartë gjatë ditës.

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 5 korrik 2013.

Prishtinë, 21 qershor 2013

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm